



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3742/2 Prot.

Pogradec, më 18 .08 .2021

VENDIM

Nr. 76 , DATË 17 . 08 2021

**PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, NË FAVOR TE
INDIVIDEVE KËRKUES PËR DEPOZITIM MATERIALE NDËRTIMI DHE
LINJE SLEKSIONIMI TE TYRE, TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE
6500 M2 (GJASHTË MIJË E PESËQIND) M2.**

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfitoaze apo kontrata te tjera te pasurise shtetore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.534, datë 01.05.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Udenisht, të Qarkut të Korçës", Vendimit nr. 1108 dt.30.12.2015 i KM "Per transferimin, nga Ministria e Bujqesise,Zvillimit Rural dhe Administrimit te ujrave,te bashkise Pogradec,te infrastruktures se ujitjes dhe kullimit,personelit dhe aseteve te luajtshme e te paluajtshme te bordeve Rajonale te kullimit"dhe sipas listes bashkengjitur keti vendimi,Rezervuari Qafe -Thane i kalon ne pronesi Bashkise Pogradec, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfitoaze apo kontrata te tjera te pasurise shtetore", te ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, per depozitim materiale ndertimi dhe linje seleksionimi per to, për pasurinë e ndodhur në Njësinë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:



Nr	Z.K	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	3565	Lin	6500	Marrje perdorim Pasurie

2. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 20 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhes te percaktuar ne projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.

3. Ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Pikes 5, shkronja "dh", Kreu I, Pikes 6, shkronja "b", germa "i", Kreu II, të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.

4. Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas shkronjës "c", pika 1 Kreu III të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.

5. Shoqëritë kërkuese të përdorin pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objketit të parashikuar ne kërkesën e tyre dhe projektin e paraqitur per marrjen në përdorim të pasurive.

6. Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kontratës, sipas tekstit bashkëngjitur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërse e tij.

7. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

8. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
Sotirag MANGËRI

